

SIGURIA E PAJISJEVE ELEKTRIKE TË TENSIONIT TË ULËT

Informacion për operatorët ekonomikë

Kjo broshurë jep informacione mbi detyrimet e operatorëve ekonomikë për të garantuar sigurinë e pajisjeve elektrike të tensionit të ulët që vendosen në treg.

Pse duhet garantuar siguria?

Pajisjet elektrike janë shumë të rëndësishme në përditshmërinë tonë. Më shumë se një shekulli pas shfaqjes së tyre, ato vazhdojnë të zhvillohen me shpejtësi dhe të sjellin përfitime të reja për shoqërinë. Në Shqipëri importohen çdo vit pajisje elektrike të tensionit të ulët me një vlerë mesatare rreth 70 miliardë lekë, të destinuara për rreth 2.350.000 përdorues. Niveli i lartë i sigurisë për këto përdorues është element thelbësor i politikës për sigurinë e produkteve në Shqipëri. Operatorët ekonomikë sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre në zinxhirin e furnizimit për vendosjen e tyre në treg duhet të përbushin një sërë detyrimesh ligjore për të arritur këtë. Për këtë qëllim lind nevoja e informimit të operatorëve ekonomikë pjesë e zinxhirit furnizues dhe përfituesve fundorë (konsumatorët).

Ku mund të merret informacion për parashikimet ligjore?

Garantimi i sigurisë për pajisjet elektrike të tensionit të ulët bazohet në rregullin teknik "Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit" i miratuar me VKM-në nr. 349/2020, nga ligji nr. 10 489/2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore" dhe ligji nr. 10 480/2011 "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore" i ndryshuar. Ato përcaktojnë rregullat për vendosjen në tregun shqiptar të këtyre pajisjeve. Këto akte ligjore si dhe informacione të tjera mbi sigurinë e produkteve mund të gjenden në faqen zyrtare të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (www.ishtm.gov.al).

Cilat konsiderohen pajisje elektrike të tensionit të ulët?

Çdo pajisje për përdorim me një tension brenda kufirit 50 deri në 1000 V për rrymën alterantive dhe prej 75 deri në 1500 V për rrymë të vazhduar konsiderohet pajisje elektrike e tensionit të ulët. Përjashtohen këtu pajisjet elektrike për përdorim në mjediset shpërthyes, për qëllime radiologjike dhe mjekësore, pajisjet elektrike të përdorura në ashensorët për mallrat dhe njerëz, prizat dhe spinat për përdorim shtëpiak, matësit e energjisë elektrike, etj (shiko rregullin teknik për listën e plotë).

Si garantohet përputhshmëria e pajisjeve elektrike të tensionit të ulët me kërkesat thelbësore të sigurisë?

Markimi CE

Markimi CE i konformitetit vendoset nga vetë prodhuesi, para se pajisja elektrike të vendoset në treg, për të vërtetuar se ajo është në përputhje me kërkesat e rregullit teknik. Markimi CE duhet të vendoset në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paqeshme në çdo pajisje elektrike ose në paketim, në dokumentin hyrës ose në certifikatën e garancisë së saj. Ndalohej vendosja mbi pajisjet elektrike i çdo markimi që mund të mashtrtojë palë të treta si në kuptimin ashtu dhe në formën e markimit CE. Mund të vendoset çdo markim tjetër në pajisjen elektrike, në paketimin e saj, në dokumentin hyrës ose në certifikatën e garancisë, me kusht që të mos reduktohet dukshmëria dhe lexueshmëria e markimit CE. Markimi CE i konformitetit përbëhet nga inicialet CE në formën e mëposhtme, duke respektuar përmasat e vizatimit të shkallëzuar:



Çfarë është Deklarata EU e konformitetit?

Çdo pajisje elektrike e tensionit të ulët që vendoset në treg, duhet të shoqërohet nga Deklarata EU e konformitetit. Ky është një dokument që lëshohet nën përgjegjësinë e plotë të prodhuesit, sipas një formati të caktuar, dhe shërben për të vërtetuar se pajisja është në përputhje me kërkesat thelbësore të sigurisë.

Deklarata EU e konformitetit duhet të përbajë elementët e mëposhtëm:

- modeli i pajisjes elektrike (produkti, tipi, numri i serisë);
- emri dhe adresa e prodhuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar;
- objekti i deklaratës (identifikimi i pajisjes elektrike që lejon gjurmueshmërinë e saj, nëse është e nevojshme mund të përbajë një imazh me ngjyra dhe mjaftueshmërisht të qartë për identifikimin e pajisjes elektrike);
- referencat e përdorura për standardet përkatëse të harmonizuara ose referencat ndaj specifikimeve të tjera teknike në lidhje me të cilat është deklaruar konformiteti;
- datën, vendin dhe nënshkrimin.

*Deklarata EU e konformitetit përketet në gjuhën shqipe ose në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesi i fundit.

✓ Detyrimet e operatorëve ekonomikë:

• Prodhuesi- Projektimi dhe prodhimi në përputhje me kërkesat ligjore.

- Siguron se pajisja elektrike është projektuar dhe prodhuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara të sigurisë;
- Siguron hartimin e dokumentacionit teknik dhe kryen procedurën e vlerësimit të konformitetit;
- Harton deklaratën EU të konformitetit dhe fikson markimin CE;
- Mban dokumentacionin teknik dhe deklaratën EU të konformitetit deri në 10 vjet nga vendosja në treg;
- Siguron që pajisja elektrike e vendosur në treg prej tij ka të shënuar tipin, serinë ose numrin serial ose elemente të tjera identifikuese (kur nuk është e mundur vendoset në paketimin ose në dokumentet shoqëruese);
- Vendos në pajisjen elektrike emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën postare; adresa duhet të tregojë një pikë të vetme kontakti dhe të dhënat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për përdoruesit e fundit;
- Siguron që pajisja elektrike të shoqërohet nga udhëzimet për përdorimin, mirëmbajtjen dhe nga informacioni për sigurinë, në gjuhën shqipe;

• Importuesi - Vendosija në treg vetëm e produkteve konform kërkesave ligjore

- Sigurohet që prodhuesi ka kryer procedurën e duhura të vlerësimit të konformitetit dhe ka hartuar dokumentacionin teknik;
- Sigurohet që pajisja elektrike ka markimin CE dhe shoqërohet me dokumentet e kërkuara dhe udhëzimet për përdorim e mirëmbajtje në gjuhën shqipe;
- Sigurohet që prodhuesi ka vendosur në pajisjen elektrike: elementet e identifikimit të saj (tipin, numrin serial), emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar, si edhe adresën e tij postare (si më sipër);
- Vendos në pajisjen elektrike emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën postare ku mund të kontaktohet;
- Siguron që gjatë kohës që pajisja elektrike është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e magazinimit dhe të transportit nuk rrezikojnë përputhshmërinë e produktit me kërkesat e përcaktuara të sigurisë;
- Mban deklaratën e konformitetit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për 10 vjet pas vendosjes së pajisjes elektrike në treg.

• Shpërndarësi - Kujdesi i duhur për kërkesat e zbatueshme ndaj produktit

- Verifikon që pajisja elektrike mban markimin CE të konformitetit;
- Verifikon që pajisja elektrike shoqërohet me dokumentacionin e kërkuar, udhëzimet dhe informacionin për sigurinë në gjuhën shqipe, lehtësisht të kuptueshme nga konsumatori;
- Verifikon nëse prodhuesi kanë përbushur detyrimet për vendosjen në pajisje të elementeve për identifikimin e saj, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar;
- Siguron që kushtet e magazinimit ose të transportit nuk e rrezikojnë përputhshmërinë e tij me objektivat e sigurisë.

Identifikimi i operatorëve ekonomikë

Operatorët ekonomikë sipas kërkesës duhet të identifikohen:

- Çdo operator ekonomik i cili ka furnizuar ata me pajisje elektrike;
- Çdo operator ekonomik të cilin ata e kanë furnizuar me pajisje elektrike.

KUIDESI!

Importuesi ose shpërndarësi konsiderohet prodhues, kur ai vendos një pajisje elektrike në treg nën emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar, ose, modifikon pajisjen elektrike të vendosur tashmë në treg në mënyrë të tillë që të ndikojë në përputhshmërinë e saj me kërkesat e përcaktuara në rregullin teknik.

✓ Kërkesat thelbësore të sigurisë:

- Pajisja elektrike duhet të projektohet dhe prodhohet në atë mënyrë që të sigurojë mbrojtjen nga rrezikët;
- Pajisja elektrike së bashku me pjesët përbërëse të saj të prodhohen në atë mënyrë që të montohen dhe lidhen në mënyrë të sigurtë dhe të rregullt.
- Pajisja elektrike duhet të projektohet dhe prodhohet në atë mënyrë që të sigurojë mbrojtjen e personave, kafshëve dhe pronës nga rrezikët që vijnë nga pajisja elektrike apo faktorë të jashtëm mbi të, me kushtin që pajisja të përdoret për qëllimin që është prodhuar dhe mirëmbahet sipas instruksioneve të prodhuesit.



Implemented by

giz
Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Publikim i mundësuar nga projekti "Mbështetje për Negociatat e Anëtarësimit në Kapitujt Ekonomikë të Acquis" (SANECA) financiar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim dhe zbatuar nga GIZ Shqipëri.

Përbajtja e kësaj broshure ka karakter informues. Detyrime ligjore të plota jepen në aktet ligjore të përmendura në brendësi të broshurës.

